

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I SHOQERISE ME ORTAKE

"ORGANICS TRADE" SHPK

KAPITULLI 1

KRIJIMI, FORMA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA

NENI 1

KRIJIMI I SHOQËRISË

1. Sot më datë 14/06/2022 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "ORGANICS TRADE" shpk, (Në vijim referuar si "Shoqëria").
2. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesa e ligjit NR.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar.
3. Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar që prej datës në të cilën organet kompetente kanë dhënë aprovimin për themelimin e saj.
4. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

NENI 2

FORMAT E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Ortakët e kësaj shoqërie nuk do të marrin një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhës nga dispozitat e këtij statute dhe dispozitat përkatëse të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuara, për aq kohë sa dispozitat e këtij statute nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e mësipërm.

NENI 3

EMËRTIMI

1. Emërtimi i shoqërisë është "ORGANIC TRADE" sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët "Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet sh.p.k

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Durrësit, në adresën: Lagjja Nr.5, Rruga Mujo Ulqinaku, Kati I 7-të, Banesa nr.39, Durrës. E-mail aidar.kamilovich@gmail.com dhe cel. +355695767901.

1. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka atë drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, degëve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit Brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një Vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.

NENI 5

KOHËZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.
2. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj në çdo kohë e kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
 - Prodhimi, tregtimi dhe përpunimi i produkteve agrokulturore.
 - Prodhimi dhe tregtimi me shumicë dhe pakice i produkteve ushqimore.
 - Prodhimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore.
 - Prodhimi dhe përpunimi i bimëve mjekësore dhe sublementeve dietike.
 - Tregëtimi me shumicë të ushqimeve dhe artikujve ushqimore.
2. Përveç aktiviteteve të parashikuara më lart, në veprimtarinë e Shoqërisë do të përfshihet çdo veprimtari tjetër që nga Ortakët do të konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme për të përmbushur objektin e Shoqërisë dhe që nuk ndalohej nga ligji.
3. Aktivitetet e Shoqërisë, për të cilat kërkohet paraprakisht një leje, licensë, autorizim apo ndonjë akt tjetër miratues, do të ushtrohen pasi të jete marre akti në fjalë.

NENI 7

EMBLEMA, VULA

1. Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Asambleja e Ortakëve dhe nga administratori i shoqërisë.
2. Forma dhe përmasa e vulës do të pëcaktohen nga Asambleja e Ortakëve pas Regjistrimit të saj, në përputhje me rregullat e legjislationit shqiptar. Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

KAPITULLI 2

KAPITALI THEMELTAR, ORTAKU, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

NENI 8

KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100 000 (njqind mijë) Lekë. Kontributi i Ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

2. Pjesëmarrja e Ortakeve në Shoqëri është në raport me kontributet e tyre, dhe vlera nominale e kuotave të tyre, e cila llogaritet në raport me këtë kontribut, është 50 000 Lekë secili, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

<u>NR.</u>	<u>Emri i Ortakut</u>	<u>Kuota</u>	<u>Vlera</u>	<u>Përqindja %</u>
<u>1</u>	<u>Aidar Mullakhmetov</u>	<u>1</u>	<u>50 000 Lekë</u>	<u>50</u>
<u>2</u>	<u>Ilmir Shafikov</u>	<u>1</u>	<u>50 000 Lekë</u>	<u>50</u>
<u>TOTALI</u>		<u>2</u>	<u>100 000 Lekë</u>	<u>100</u>

3. Kapitali mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakeve sipas normave të fushës në fuqi.
4. Kapitali është shlyer tërësisht.

NENI 9

ORTAKET DHE KUOTAT

1. Shoqëria përbëhet nga dy Ortakë, me të dhënat e mëposhtme:
- Aidar Mullakhmetov, shtetas i huaj, madhor me zotësi juridike për të vepruar, i lindur më 14.09.1998 në Rusi, banues në Lagjja Nr. 5, Rruga Mujo Ulqinaku, Kati I 7të, Banesa nr.39, Durrës, mbajtës i pasaportës me nr. 750945866 nr. Cel +355695767901, i cili zotëron 50 % të kuotave.
 - Ilmir Shafikov, shtetas i huaj, madhor me zotësi juridike për të vepruar, i lindur më 26.06.1978 në Rusi, banues në Lagjja Nr. 5, Rruga Mujo Ulqinaku, Kati I 7të, Banesa nr.39, Durrës, mbajtës i pasaportës me nr. 759561190, i cili zotëron 50 % të kuotave
2. Ortaket e shoqërisë zotërojnë kuotat si më poshtë:
- Aidar Mullakhmetov zotëron 1 kuotë, me vlerë 50% të kapitalit.
 - Ilmir Shafikov zotëron 1 kuotë, me vlerë 50% të kapitalit.

NENI 10

MËNYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b. Shitblerjes;
 - c. Trashëgimisë;
 - d. Dhurimit;
 - e. Cdo mënyrë tjetër parashikuar në ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së cmmimit, rregullohen nga kontrata.

3. Kontrata për kalimin e kuotave hartohet në formë shkrese dhe noterizimi nuk përben kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.
4. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakort në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshirë këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.
5. Kuotat që shiten kanë vlerën fillestare të regjistrimit të kapitalit fillestar, nëse shoqëria deri në momentin e fillimit të procedurës së shitjes nuk ka bërë rritje kapitali sipas ligjit dhe të rregjistruar në QKB, me përjashtim të rastit kur palët bien dakort për një vlerë më të lartë.
6. Vendosja e çfarëdoqë barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pelqimin e shprehur me anë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 11

PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga casti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të nenit 74 të Ligjit për shoqëritë tregtare.
2. Shoqëria realizon kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03/05/2007 për "Qendrën Kombëtare të Biznesit".

KAPITULLI 3

MARRËDHENIET NDËRMJESHQËRISË DHE ORTAKUT

NENI 12

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

1. Ortaket kanë të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë që janë miratuar me vendim nga Asambleja e Ortakëve. Shoqëria mund të mos ndajë fitim edhe kur realizon fitim, nëse mbledhja e asamblesë ka vendosur për këtë qëllim.
2. Administratori i shoqërisë në rastin e shpërndarjes së fitimit duhet që dokumentin përkatës që autorizon strukturën përkatëse për kalimin e fitimeve tek Ortakët e Shoqërisë, ta shoqërojë me Vendimin përkatës të Asamblese.

NENI 13

KUFIZIMET E SHPËRNDARJES, ÇERTIFIKATATA E AFTËSISË PAGUESE, PËRGJEGJESITË

1. Shoqëria mund të shpërndarë fitimin për Ortakët, vetëm nëse pas pagimit të fitimit:
 - a. Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj.
 - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme Brenda 12-muajve në vazhdim.
2. Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e fitimit përmbush kërkesat e paragrafit të parë të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë

tregon se shpërndarja e propozuar e fitimit nuk i përmbush këto kritere, administrator nuk mund të lëshojë këtë certifikatë.

3. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.
4. Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e fitimit të shpërndarë.
5. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria fitimin, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e tij, pavarësisht lëshimit të certifikatës, nëse ka pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë sipas paragrafit të parë të këtij neni.

KAPITULLI 4

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Ortakëve.
2. Administratori.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

NENI 14

TE DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e Ortakëve merr Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë. Vendimet e Ortakëve përfshijnë kryesisht, por pa u kufizuar, çështjet e mëposhtme:
 - a) Përcaktimin dhe mbikëqyrjen e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërtimin dhe shkarkimin e administratorëve si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
 - d) Emërtimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
 - e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - g) Riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
 - h) Miratimin e strukturës së shoqërisë dhe nivelet e pagave për vend pune;
 - i) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
 - j) Miratimin e marrjes së kredive bankare;
 - k) Shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërish;
 - l) Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe rregulloreve të tjera që në thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së shoqërisë;
 - m) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - n) Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar apo ky Statut.
2. Duhet regjistruar në vecanti në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por pa u kufizuar në to, vendimet e Asamblesë së Ortakëve për:
 - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime; Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
 - d) Vendime të tjera që Asambleja e Ortakëve vlerëson se duhen regjistruar.

3. Te gjitha Vendimet e asamblesë së Ortakëve ruhen në një regjistër të veçantë. Sipas numrit dhe datës. Administratori përgjigjet për rregullsinë e regjistrit. Vendimet e paregjistruara në Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kunderdrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të kishte pasur dijeni për të.

ADMINISTRATORI

NENI 15

EMËRTIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Ortakët emërojnë një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5(pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Ortakëve merr vendim të posaçëm për riemërimin e Administratorit pas periudhës së emërimit të parë.
2. Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë dhe drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke siguruar që menaxhimi i Shoqërisë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, Administratori ka të drejtën të nënshkruajë aktet dhe dokumentat e Shoqërisë, përfshirë hartimin e të gjitha vendimeve të Shoqërisë.
3. Caktimi i Administratorit bëhet ng sky statut për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë riemërimi nga Ortakët. Administrator i shoqërisë caktohet Ortaku **Aidar Mullakhmetov**, shtetas i huaj, madhor me zotësi të juridike për të vepruar, i lindur më 14.09.1998 në Rusi, banues në Lagjja Nr.5, Rrug "Mujo Ulqinaku", Kati i 7-të, Banesa nr. 39, Durrës, Mbajtës i pasaportës me nr.750945866 nr. Cel0079966067500.
4. Administratori ka të drejtë e detyrohët të:
 - a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare
 - b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrdhenie me të tretet, personalisht ose me përfaqësim, tek palët e treta, institucione apo entitete publike ose private;
 - c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentacioneve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) Mbajtja e një regjistri të veçantë ku të bëjë regjistrimin e të gjitha Vendimeve të Asamblesë së Ortakëve;
 - e) Të lidhe kontratat e punës me punonjësit e shoqërisë;
 - f) Të mbajë korendpandencë të rregullt me të tretët, si dhe të marrë të gjitha masat që kjo të jetë e arkivuar në arkivën e shoqërisë;
 - g) Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - h) Të kryejë regjistrimet dhe të dergojë të dhenat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 - i) Të kryejë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në këtë statut.

NENI 16

PËRFAQËSIMI

1. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet në menyrë të arsyshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Administratori mund të autorizojë një të tretë, me anë të një procure të posacme, për kryerjen e të gjitha kompetencave të përshkruara në nenin 15 të këtij Statuti si dhe për ato kompetenca që i lindin në bazë të Ligjit tregtar.

NENI 17

SHPËRBLIMI

1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa. Shtesat bëhen me vendim të asamblesë së Ortakëve.
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare të shoqërisë dhe të respektojë nivelet minimale të kërkuara nga legjislacioni në fuqi
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 18

VITI FINANCIAR, BILANCI, KONTABILITETI, HUMBJET DHE FITIMET

1. Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti. Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.
2. Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
3. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së vitit financiar, pas pagimit të detyrimeve, i kalojnë Ortakëve.
4. Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe Ortakët do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e vitit financiar të parë deri në tre vitet pasardhës.

NENI 19

EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

1. Ortakët mund të emërojnë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.
2. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike-tregtare të Shoqërisë, atë vjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe i ka kryer këto duke qenë i ngarkuar nga Ortakët.

3. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të raportit vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë Ortakëve për t'i shqyrtuar dhe miratuar mbi bazë e të drejtës së tij vendimmarrëse.

KAPITULLI 5 PRISHJA E SHOQËRISË, LIKUIDIMI

NENI 20 SHKAQET E PRISHJES SE SHOQËRISË

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) Me përfundimin e procedurave të falenderimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurave të falimentimit.
 - b) Në rast se objekti bëhet i përealizueshëm apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare.
 - c) Në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit tregtarë.
 - d) Në raste të tjera, të parashikuara në statut.
 - e) Në raste të tjera të parashikuara në ligj.
 - f) Për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Ortakëve.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara më sipër, vendoset nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
3. Me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

NENI 21 REGJISTRIMI I SHPERBERJES

1. Administratori ka detyrë të regjistrojë shpërbërjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykatë, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" l'a njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim.
2. Në rastin e prishjes së shoqërisë, pavarësisht institucionit që ka marrë vendimin, ngarkohet administrator që të kryejë procedurat deri në përfundim të këtij procesi, për aq kohë sa kjo dispozitë e statutit nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

NENI 22 LIKUIDIMI NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

1. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 130 deri në 205 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

NENI 23

PROCEDURA E SHNDËRRIMIT

1. Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore me miratimin e Ortakëve, nëpërmjet shndërrimit, sipas procedurës së parashikuar në Ligjin Tregtar.
2. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Marrëdhënia e brendshme në fushën e menaxhimit dhe administrimit të Shoqërisë midis administratorit, Ortakëve, dhe çdo të punësuar në Shoqëri, do të rregullohen me anën e një rregulloreje të miratuar nga Ortakët.
3. Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me Ligjin Tregtar.

NENI 24

DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT

1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë që lidhet me funksionimin e shoqërisë, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij statute.
 2. Në çdo rast kur legjislacioni shqiptar përkatës mund të ndryshojë, ky statut me vendim të Asamnlësë së Ortakëve, sipas rregullave të përcaktuara mund të ndryshohet, në përputhje me ndryshimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.
- Ky akt themelimi dhe statut hartohet në 3 kopje origjinale, dhe hyn në fuqi për palët nënshkruese nga data e nënshkrimit të tij dhe prodhon efekte ndaj të tretëve nga data e regjistrimit të tij në QKB

ORTAKËT E SHOQËRISË

"Aidar Mullakhmetov"



"Ilmir Shafikov"

